



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:237249  
Datë: 27.01.2023  
Numri i dokumentit: 03912320

**C-IV - 15 - 0900**

**Paditësi:** A S Podujevë

**Kundër**

**Të paditurës:** A. „I” Podujevë , e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr. “Driton Hoxha ” nr. 55 , Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me 25 janar 2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e paditësit A S kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN 055- 0051, më dt. 22. 04. 2015.**
- II. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.**

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me dt. 27. 05. 2015, pranë DHPGJS, është parashtruar ankesa e paditësit kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për A „I ” PRN 055- 0051, dt. 22.04.2015 me të cilën është refuzuar kërkesa për kompensimin e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, në shumën e pa specifikuar .

Është deklaruar se ankesën se ka qenë punëtor te i paditurit prej dt. 15.03.1997, e deri më dt. 25.05.2015.

Prej dt. 20.09.2008, A Sh I është mbyllur dhe kam vendimin si rojtar i objektit . Prej Vitit 2008 deri në vitin 2013, është dhënë në shfrytëzim objekti një automekaniku H H i cili më ka paguan pagë mujore 140€.

Ka bashkangjitur si provë :

- Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN 055- 0051,
- Letër konfirmimin e lëshuar nga AKP-ja dt. 07.05.2015,
- Aktvendimin për caktimin në vendin e punës , dt. 10.03.1997,
- Kontratën e punës 26.08.2007,
- Kopjen e Librezës së punës,
- Kontratën për dhënien e lokalit në shfrytëzim me kompensim mujor në shumë 140.00€.
- Kopjen e dokumentit identifikues .

Më dt. 25.10.2022, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka lëshuar urdhër për paditësin C-IV- 15- 0900, me të cilin i ka kërkuar të dorëzoi njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës për shkak të likuidimit .Me të njëjtin është njoftuar edhe për pasojën juridike.

Më dt.02.11.2022, paditësi ka dorëzuar një parashtresë me të cilën është deklaruar se kërkesa e tij ka të bëjë me njohjen e drejtës për të përfituar në 20 % nga shitja e Ndërmarrjes , dhe ka bashkangjitur :

- Listën përfundimtare të punëtorëve për NSH Instruktorit, të publikuar nga AKP, dt. 19.07.2019,
- Përgjigjen e AKP-së , për rastin C- II- 19- 0044- C0001, dt. 15.08.2019, dhe provat e dorëzuara në anekse.

Më dt. 14.11.2022, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtresën në mbrojtje ndaj ankesës së ushtruar kundër Vendimit të AL PRN 055- 0051, me propozim që ajo të refuzohet.

Në parashtresë është deklaruar se NSH, ka hyrë në procedurë të likuidimit, më dt. 07.07.2014, ndërsa paditësi ka ushtruar kërkesë kreditore për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën e pa specifikuar më dt. 16.09.2014.

Më dt. 23.04. 2015, AL mori Vendimin PRN 0055- 0051, duke refuzuar kërkesën plotësisht.

Vendimi i AL mbështetet në faktet dhe bazat ligjore në vijim:

- i. Neni 40.21.6.2 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, parasheh ,, të drejtën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes , apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në '' .

Në parashtresë është deklaruar se parashtruesi i kërkesës vërteton vet se marrëdhënia e punës me NSH ka përfunduar më dt. 01.03.2006 dhe i njëjti nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH –së, kur NSH ka hyrë në procedurë të likuidimit më dt. 07.07.2014, dhe si rrjedhojë e kësaj atij nuk ju është ndërprerë kontrata e punës si pasojë e Vendimit të marr nga AKP-ja neni 6.1 apo 6.2 e Ligjit për AKP.

## **Arsyetimi Ligjor**

### **Ankesa nuk është e bazuar .**

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi procedurën kontestimore, Gjykata nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata, ka shqyrtuar pretendimet e paditëses në ankesë dhe provat të cilat i ka bashkangjitur, sikundër edhe pretendimet e të paditurit, dhe ka konstatuar se paditësi ishte punëtore e të paditurës, sipas konfirmimit të lëshuar nga AKP-ja më dt. 07.05.2015, për periudhën 15.03.1997 deri më dt. 20.09.2008., pavarësisht faktit se në Librezë zë punës , e cila është hapur më dt. 15.03.1997, atij nuk ju është mbyllur Libreza e punës ..

Për të paditurën si kontestuese është baza juridike e kërkesës për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës .

Me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN 055- 0051 kërkesa e A S për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën e pa specifikuar është refuzuar, duke u mbështetur në nenin 40.1.6.2 , të Shtojcës së Ligjit.

Me nenin 31.5 të Ligjit nr. 06/L-086 është paraparë, ,, Në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt , ajo palë është e obliguar të paraqesë prova , fizike dhe ose dëshmuese për mbështetjen e atij pohimi ”

Gjykata palës paditëse, ja dha mundësin që me Urdhër C- IV- 15- 0900 , dt. 25.15.2022, të dorëzoi provën e njoftimi me të cilin ju është ndërprerë marrëdhënia e punës , por këtë provë nuk dorëzoi, ndërsa në lidhje me mos dorëzim të provës nuk është deklaruar .

Pala ka dorëzuar prova që nuk kanë të bëjnë me kërkesën në ankesës , por kanë të bëjnë me rastin tjetër që ka si, C- II- 19- 0044- C001 , e të cilat prova janë të pa rëndësishme .

Me dispozitën e nenit 40 paragrafi 1. pika 1.6 .2, e Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, është parapa ,, kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në ” .

Çështja e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës është e rregulluar edhe me Ligjin e punës 03/L-212 si ligj në fuqi kur ka filluar procedura e likuidimit të NSH –së , me dispozitën e nenit 76, largimi kolektiv nga puna .

Gjykata vlerëson se në rastin konkret paditësi me asnjë provë të vetme nuk ka vërtetuar faktin se deri te ndërprerja e marrëdhënies së punës, ka ardhur si rrjedhojë e Vendimit për likuidim të ndërmarrjes nga Bordi i AKP-së, kjo sepse në ditën e marrjes së vendimit, paditësi me asnjë provë të vetme nuk ka vërtetuar faktin se ka qenë duke punuar dhe ka realizuar pagë te i paditurit si dhe ishte në listën e pagave.

Gjykata vlerëson se qëllimi i kompensimit të punëtorëve të cilëve ju ndërpritet kontrata e punës në mënyrë të parakohshme si pasojë e ndryshimeve strukturore në Ndërmarrje është e karakterit social që punëtori varësisht nga stazhi i punës të përfitojë disa paga dhe me to ta mbajë vetën dhe familjen derisa të gjen ndonjë vend tjetër pune dhe këtë periudhë ta ketë më lehtë ta tejkaloj situatën sociale të shkaktuar për shkak të ndërprerës së parakohshme të marrëdhënies së punës.

Gjykata vlerëson se paditësi nuk i plotëson kriteret që të përfitoj nga dëmshpërblimi për shkak të ndërprerës së parakohshme të kontratës së punës sipas nenit 40 paragrafi1, pika 1.6.2 e Shtojcës së ligjit lidhur me nenin 76 të Ligjit të punës, për arsye se deri te ndërprerja nuk ka ardhur si pasojë e Vendimit të Bordit të AKP-së, por ndërprerja faktike e punës është shkaktuar

para marrjes së Vendimit të Bordit të AKP-së për fillimin e procedurës së likuidimit në NSH dhe kur NSH është mbyllur siç deklarohet vetë paditësi, ndërsa objektet e NSH –së janë dhënë me qira sipas kontratës së dt. 22.02.2008 .

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

**Shpenzimet Gjyqësore:**

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të heqë shpenzimet e veta të procedurës .

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva

Gjyqtar